



REPUBLIKA E SHqipëRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË



1

ANALIZË E PUNËS SË DAR QARKUT TIRANË

01.02.2019

Analiza e punës së Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë është organizuar, në bazë të analizës të përgatitur nga:

I. Sektori i Programeve të Zhvillimit (Burimet Njerëzore)

II. Sektori i Kurrikulës dhe Cilësisë

III. Sektori IT dhe Statistikës

IV. Sektori i Financës e Shërbimeve të Përgjithshme

A. Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë për vitin shkollor 2017-2018.

Veprimtaria u përqendrua në përmirësimin cilësor të menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në zbatim të:

- Udhëzimit nr.38, dt.06.10.2015 “Për procedurat e levizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” nëpërmjet të cilit emërimi i punonjësve të rinj arsimor bëhet sipas renditjes në Portalin “Mësues për Shqipërinë”.
- Udhëzimi nr.38, dt.07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit më aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”
- Udhëzimi nr 44,dt 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MASH nr.21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Zbatimin e procedurave të rekrutimit të psikologëve të shkollave, sipas urdhrit të MASH nr.344, datë 19.08.2013 i Dispozitave Normative.
- Zbatimi me korrektësi i urdhrit të MASH nr.57, datë.12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.
- Zbatimin e Udhëzimit të MASH nr.12.02.2015 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, për mësuesit të cilët plotësojnë kushtet e kualifikimit, sipas shkallës së kategorive: III, II, I.

Për vitin shkollor 2017-2018 Sektori i Programeve të Zhvillimit kishte si prioritet këto objektiva:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit arsimor publik dhe jopublik
- Zhvillimi dhe rritja e cilësisë së mësimdhënies së arsimit public, nëpërmjet një menaxhimi të mirë të Burimeve Njerëzore, duke ndjekur me kujdes punësimin e punonjësve të rinj, sipas renditjes së Portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- Ndjekje dhe zbatimin për “arsim gjithëpërfshirës” dhe barazi për të gjithë nxënësit, sidomos për ata me nevoja të veçanta gjatë procesit të mësimdhënies.
- Kontrollin dhe vlerësimin e performancës së drejtuesve të institucioneve arsimore ndaj personelit në vartësi të tyre.
- Kontroll në zbatimin e shpërndarjes së normës mësimore të personelit në shkollë.
- Regjistrimin e mësuesve për kualifikim, duke zbatuar plotësimin e kriterëve sipas diplomës dhe vjetërsisë në punë.

- Ndërtimin e një lidhje të qëndrueshme me komunitetin e interesuar për punën e personelit mësimor e drejtues në institucionet e arsimit publik.
- Plotësim dhe përditësim të dokumentacionit në dosjet e personelit të DAR Qarku Tiranë.
- Marrja në dorëzim dhe plotësim dokumentacioni të punonjësve të rinj dhe për ata në vazhdim.
- Përgjigje të kërkesave të punonjësve mësimor për vërtetime të ndyshme që lidhen me pozicionin e punës.
- Përgjigje të kërkesave të MASR-së, institucionit të sigurimeve shoqërore, si dhe institucioneve të tjera lidhur me dokumentacionin e arkivuar të punonjësve.
- Rritja e transparencës dhe forcimin e besimit të publiku në sistemin arsimor.

B. PORTALI 2018

Edhe për vitin shkollor 2017-2018 vazhdoi të rritet besimi e kandidatëve në pjesëmarrjen e portalit “Mësues për Shqipërinë”, si e vetmja mundësi punësimi, pasi gjithçka bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, duke garantuar qëndrueshmëri dhe vijimësi. Këtë e dëshmon dhe pjesëmarrja e madhe e kandidatëve të portalit “Mësues për Shqipërinë 2018”, në të cilin në fazën e parë të konkurrimit, sipas udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “ Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, u vlerësuan dosjet e 402 kandidatë sipas këtyre profileve, si më poshtë vijon:

Sektori i Programeve të Zhvillimit (Burimet Njerëzore)

Nr	Profili	Gjithsej
1	Arsimi fillor	43 kandidatë
2	Edukim fizik	11 kandidatë
3	Arsim parashkollor	17 kandidatë
4	Gjuhë angleze	24 kandidatë
5	Gjuhë frënge	12 kandidatë
6	Gjuhë italiane	5 kandidatë
7	Gjuhë shqipe dhe letërsi	79 kandidatë
8	Fizikë	16 kandidatë
9	Matematikë	37 kandidatë
10	Biologji	43 kandidatë
11	Histori	36 kandidatë
12	Kimi	19 kandidatë
13	Gjeografi	55 kandidatë
14	Art muzikor	1 kandidat
15	Shkenca Sociale	4 kandidatë

C. PUNËSIMET

Për vitin shkollor 2017-2018 janë emëruar nga portali 60 mësues, duke respektuar parimet e meritokracisë, paanësisë dhe të transparences, duke i dhënë prioritetin që meriton këtij procesi kaq delikat dhe të rëndësishëm për arsimin shqiptar.

Sipas profileve:

Nr	Profili	Gjithsej
1	Arsimi fillor	17 mësues
2	Edukim fizik	8 mësues
3	Arsim parashkollor	9 mësues
4	Gjuhë angleze	7 mësues
5	Gjuhë frënge	1 mësues
6	Gjuhë italiane	1 mësues
7	Gjuhë shqipe dhe letërsi	1 mësues
8	Fizikë	4 mësues
9	Matematikë	9 mësues
10	Biologji	1 mësues
11	Histori	1 mësues
12	Kimi	1 mësues

D. LËVIZJA DHE PËRQENDRIMI I SHKOLLAVE

Për vitin shkollor 2017-2018, ishin 4 institucione shkollore që kaluan në varësi të institucioneve të tjera shkollore, me qëllim përmirësimin e cilësisë në arsim dhe një menaxhimi më të mire dhe më efikas të Burimeve Njerëzore.

Kështu shkolla 9-vjeçare Sharrë kaloi si shkollë vartëse e shkollës 9-vjeçare Gropaj.

Shkolla 9-vjeçare “Ejona Dinga” Shkallë, së bashku me shkollat vartëse, kaloi në përgjegjësinë e shkollës së mesme të bashkuar “Ymer Lala” Surrel.

Nxënësit e shkollës 9- vjeçare Darshen shkuan në shkollën 9-vjeçare Selbë.

Nxënësit e ciklit fillor në shkollën 9-vjeçare Gjysylkanje, kaluan në shkollën 9-vjeçare Pajanë (vartëse e shkollës së mesme të bashkuar Pezë e Madhe).

I gjithë ky proces u shoqërua me transferimin e 19 mësuesve në institucionet e tjera dhe të gjithë mësuesit u sistemuan dhe askush nuk rrezikoi vendin e punës.

E. KUALIFIKIMI I MËSUESVE PËR VITIN SHKOLLOR 2017-2018

Ishin 80 mësues, të cilët morën në testimin që u mundëson atyre një titull kualifikimi më të lartë, në varësi të shkallës së profesionalizmit që ata zotërojnë, për vitin shkollor 2017-2018, nga të cilët:

- Pjesëmarrja sipas cikleve shkollore

Nr	Cikli	Mësues
1	Arsimi parashkollor	3 mësues
2	Arsimi fillor	14 mësues
3	Arsimi i mesëm i ulët	37 mësues
4	Arsimi i mesëm i lartë	26 mësues

- Mësues sipas kategorisë së kualifikimit morën pjesë:

Nr	Kategoria	Mësues
1	Kategoria I	20 mësues
2	Kategoria II	40 mësues
3	Kategoria III	20 mësues

- Rezultatet e kualifikimit:

Nr	Vlerësimi	Mësues
1	A	7 mësues
2	B	30 mësues
3	C	37 mësues
4	D	3 mësues
5	E	3 mësues

- Rezultatet në përqindje

Nr	Vlerësimi	Mësues
1	Shkëlqyer	8.7 %
2	Shumë Mirë	37.5%
3	Mirë	46.25%
4	Mjaftueshëm	3.75%
5	Dobët	3.75%

F. INFORMIMI DHE TRANSPARENCA

Për garantimin e njohjes së publikut me informacionin që zotëron autoriteti ynë publik, me qëllimin dhe nxitjen e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë ligjore, për vitin shkollor 2017-2018, ka funksionuar me efikasitet dhe me rezultat Komisioneri për të Drejtën e Informimit, sipas kriterëve ligjore që parashikon ligji 119/2017 “ Për të drejtën e informimit”, ku kanë marrë informacionin e kërkuar disa individë dhe organizata joqeveritare. Gjithçka është transparente dhe shumë informacione të nevojshme për publikun gjenden në faqen zyrtare (elektronike) të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë.

G. PORTALI I BASHKËQEVERISJES “PËR SHQIPËRINË QË DUAM”

Portali i bashkëqeverisjes ka qenë një instrument i dobishëm dhe efikas për të dhënë llogari te qytetarët në lidhje me çdo vendimmarrje të kryer nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë dhe për çdo paqartësi dhe ankesë.

Janë trajtuar 12 raste për vitin shkollor 2017-2018 dhe të gjithë rastet e ardhura kanë marrë përgjigje dhe zgjidhje sipas problematikës që sillnin, në respekt të zbatimit të ligjit.

Ky komunikim me publikun shton përgjegjësitë tona për të patur si objektiv të vetëm të punës sonë ligjshmërinë dhe efikasitetin.

GJ. HRMIS (HUMAN RESOURCES MENAGMENT SISTEM)

Hedhja të të dhënave për të gjithë mësuesit e institucioneve shkollore, në varësi të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, në sistemin elektronik HRMIS, që administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, përfundoi me sukses në fund të muajit janar 2018. Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë ishte nga të parët institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, që përfundoi me sukses krijimin e dosjeve elektronike për të gjithë Burimet Njerëzore, pra për 1347 punonjës.

Vazhdon hedhja dhe përditësimi i të dhënave në sistem, për të gjitha rastet kur ka punonjës të rinj të punësuar apo për rastet e transferimeve apo largimeve.

H. MËSUESIT NDIHMËS

Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë ka trajtuar me përparësi arsimimin e fëmijëve me aftësi të ndryshe, duke i mbështetur këta fëmijë, nëpërmjet mësuesve ndihmës, me qëllim integrimin e tyre për një “arsim gjithëpërfshirës” dhe barazi për të gjithë, gjatë procesit të mësimdhënies.

Nga 4 mësues ndihmës që ishin për vitin shkollor 2016-2017, në fund të vitit shkollor 2017-2018 ky numër do të shkonte në 14 mësues ndihmës.

Aktualisht janë 36 institucione arsimore në juridiksionin e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë që ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve me aftësi ndryshe, dhe janë 39 mësues ndihmës që mbështesin këta fëmijë në procesin mësimor, numër që padyshim do të shtohet.

A. VEPRIMTARITË E PLANIFIKUARA NGA SEKTORI I KURRIKULËS DHE CILËSISË PËR VITIN 2017-2018 BUROJNË:

- Nga detyrat që SKC-ja ka planifikuar planin e punës për vitin 2017-2018
- Nga detyrat e ngarkuara nga MASR-ja drejtoria e arsimit parauniversitar në kuadër të bashkërendimit të punës me drejtoritë arsimore .
- Nga projekte risi dhe reforma të ndërmarra nga nevojat e realitetit arsimor shqiptar, me qëllim ofrimin e zgjidhjeve afatshkurtra e afatgjata në fusha e aspekte të ndryshme të tij.
- Nga angazhimet e ndërmarra në kuadrin e projekteve me partnerë si UNICEF-ja, UNESCO, SAVE THË CHILLDREN,UMFPA-ja etj. Sektori i Kurrikulës dhe Cilësisë për vitin shkollor 2017-2018 realizoi me sukses detyrat dhe objektivat e përcaktuara, duke siguruar mbështetjen për institucionet arsimore për:
 - Zbatimin e kurrikulës,
 - Identifikimin e nevojave për zhvillimin profesional,
 - Ndjekjen e ecurisë së projekteve në fushën e kurrikulës,
 - Vlerësimet e jashtme të arritjeve të nxënësve, siç janë provimet e MSH-së dhe Provimet e Lirimit, procesin e altermekstit dhe problemet e ndryshme që lidhen me krijimin e një mjedisi cilësor të mësimdhënies. Vëmendje të veçantë i kushtuam zbatimit të kurrikulës me kompetenca në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, si dhe pilotimit të kësaj kurrikule në klasat IV dhe IX të shkollave pilot. Në këtë kontekst janë realizuar mjaft trajnime, mentorime dhe monitorime, të cilat kanë ndikuar mjaft pozitivisht në refleksione reale dhe projeksione të qarta për të ardhmen.

C. REZULTATE TË PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, PKAB 2017-2018

Bazuar në udhëzimin nr 774, datë 22.11.2018 “Për miratimin e rregullores për ‘Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë’”, në datat 11,18 dhe 22 qershor u organizuan provimet kombëtare të arsimit bazë në lëndët gjuhë e huaj, gjuhë shqipe dhe matematikë. Ky proces u organizua në 21 qendra provimi me pjesëmarrjen e 1801 nxënësve. Në administrimin e procesit morën pjesë 340 mësues.

Kalueshmëria PKAB 2018 për të tri lëndët të marra së bashku është 99 % .

Nota mesatare 7.2 .

Përqindja më e lartë 48.8 % është në nivelin e notës 7-8, çka do të thotë që arritjet e nxënësve janë mbi nivelin mesatar.

Rezultatet të specifikuar janë si më poshtë:

GJUHË E HUAJ


Kalueshmëria 100% dhe nota mesatare 7.9

14.2 % e nxënësve janë me vlerësime 5 ose 6;

53.6 % e nxënësve janë me vlerësime 7 ose 8;

32.2 % e nxënësve janë me vlerësime 9 ose 10;

REZULTATET E GRUPUARA NE NIVELE, GJUHE E HUAJ



GJUHË SHQIPE


Kalueshmëria 99.8% dhe nota mesatare 7.3

27.2% e nxënësve janë me vlerësime 5 ose 6;

58.4% e nxënësve janë me vlerësime 7 ose 8;

14.2 % e nxënësve janë me vlerësime 9 ose 10

REZULTATE TE GRUPUARA NE NIVELE,GJUHE SHQIPE



MATEMATIKË


99.7 % dhe nota mesatare 6.5

56.7 % e nxënësve janë me vlerësime 5 ose 6;

34.6 % e nxënësve janë me vlerësime 7 ose 8;

8.4 % e nxënësve janë me vlerësime 9 ose 10;


REZULTATE TË GRUPUARA NË NIVELE, MATEMATIKË




RENDITJA PROGRESIVE E SHKOLLAVE KUNDREJT NOTËS MESHATARE-PKAB 2018

NR	SHKOLLA	NOTA MESHATARE
1	LUNDËR	8.3
2	FARKË E VOGEL	8.2
3	NDROQ-9VJ	7.8
4	QESARAKË	7.8
5	BËRZHITË	7.8
6	FARKË E MADHE	7.7
7	VORË	7.7
8	KASHAR KODËR	7.7
9	MULLET	7.7
10	YRSHEK	7.7

RENDITJA PROGRESIVE SIPAS NOTËS MESHATARE



REZULTATET E PKAB 2018, KRAHASUAR ME PKAB 2017



Kalueshmëria 95% dhe nota mesatare 6.9
23% e nxënësve janë me vlerësime 5 ose 6;
55 % e nxënësve janë me vlerësime 7 ose 8;
27 % e nxënësve janë me vlerësime 9 ose 10;



Kalueshmëria 99.8% dhe nota mesatare 7.3
27.2% e nxënësve janë me vlerësime 5 ose 6;
58.4% e nxënësve janë me vlerësime 7 ose 8;
14.2 % e nxënësve janë me vlerësime 9 ose 10;



+4.8 % në kalueshmëri.
+0.4 njësi notë në notën mesatare.
+3.4 % në fishën e vlerësimeve me notën 9 e 10;



2017


Kalueshmëria 97% dhe nota mesatare 6.6
22 % e nxënësve janë me vlerësime 5 ose 6;
49 % e nxënësve janë me vlerësime 7 ose 8;
27 % e nxënësve janë me vlerësime 9 ose 10;

2018

Kalueshmëria 100% dhe nota mesatare 7.9
14.2 % e nxënësve janë me vlerësime 5 ose 6;
53.6 % e nxënësve janë me vlerësime 7 ose 8;
32.2 % e nxënësve janë me vlerësime 9 ose 10;

2018/2017

+ 3 % në kalueshmëri.
+ 1.3 njësi notë në notën mesatare.
+ 4.6 % në fishën e vlerësimeve me notën 7 e 8;
+5.2 % në fishën e vlerësimeve me notën 9 e 10;



D. REZULTATE TË VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR, KLASA V, 2018.

Në zbatim të urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.167, datë 11.04.2018 “Për miratimin e rregullores për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor, 2018 ”, udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.4, datë 11.04 2018 “Për zhvillimin e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor 2018” u realizua në të gjitha shkollat e qarkut Tiranë, procesi i vlerësimit të jashtëm në nxënësve të klasave të pesta. Nënvizojmë se, pavarësisht rezultateve të nxënësve në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre, qysh në testin kombëtar, më tepër se kurrë, pati ndikim sensibilizimi i mësuesve, nxënësve dhe interesimi i prindërve për një përgatitje dhe përkushtim për arritjen e rezultateve në testim. Në kohë DAR Qarku orientoi drejtoritë e shkollave dhe mësuesit e këtyre klasave për të qenë më të vëmendshëm në drejtim të një pune konkrete me nxënësit. Vlerësimi u realizua në 46 qendra, ku morën pjesë 101 shkolla, përfshi dhe shkollat vartëse, dhe u testuan 1585 nxënës. Procesi u administrua nga 190 mësues. Kujdes u tregua në korrektësinë e realizimit të testimit.

- Përqindja më e madhe është përqendruar në intervalin 36-46 pikë, ndërkohë që totali i pikëve ishte 60.
- Niveli rajonal i arritjeve të nxënësve është mbi mesatar, që do të thotë se nxënësit e klasës së 5-të janë në gjendje që mesatarisht të zgjidhin më shumë se gjysmën e kërkesave të testit

Rezultatet e VANAF-it janë si më poshtë vijon:

PËRQINDJA E SAKTËSISË SIPAS SECILËS LËNDË

Nr	Shkolla	Nr.nxënësve pjesëmarrës	Pikë të grumbulluara në Gjuhë shqipe	% Saktësisë në gjuhë shqipe	Pikë të grumbulluara në Matematikë	% Saktësisë në Matematikë	Pikë të grumbulluara në DN	% Saktësisë në DN
1	Arbanë	20	219	54%	259	64%	131	65%
2	Prush	26	322	61	280	53	179	68
3	Lalm	14	155	55	118	42	62	44
4	Sharr	6	63	52	57	47	34	56
5	Vaqarr	21	303	72	295	70	158	75
..
..
58	Farkë e Madhe	37	437	59	381	51	234	63
59	Farkë e Vogël	25	302	60	319	63	148	59
60	Mjull Bathore	6	59	49	62	51	28	46
61	Lundër	24	312	63	285	59	156	65
62	Ferraj	16	178	55	249	77	102	63

RENDITJA E SHKOLLAVE NË GJUHË SHQIPE.

Nr	Shkolla	Nr.nxënësve pjesëmarrës	Pikë të grumbulluara në Gjuhë shqipe	% Saktësisë në gjuhë shqipe
1	Sarina	28	484	86
2	Bërzhitë	23	375	81
3	Vahid Haka	14	221	78
4	Pezë Helmës	35	539	77
5	14 Nentori	12	178	74
..
..
57	Shkallë	8	79	49
58	Mjull Bathore	6	59	49
59	Mangull	13	123	47
60	Kllojkë	5	45	45
61	Bari Nela	8	62	38

RENDITJA E SHKOLLAVE NË MATEMATIKË.

Nr	Shkolla	Nr.nxënësve pjesëmarrës	Pikë të grumbulluara në Matematikë	% Saktësisë në Matematikë
1	Sarina	28	517	92
2	Ahmetaq	26	417	80
3	Baldushk	20	314	78
4	14 Nentori	12	187	77
5	Ferraj	16	249	77
..
..
57	Mustafa Lleshi	14	125	44
58	Shkallë	8	69	43
59	Lalm	14	118	42
60	Zall Dajt	17	145	42
61	Kllojkë	5	40	40

RENDITJA E SHKOLLAVE NË DITURI NATYRE.

Nr	Shkolla	Nr.nxënësve pjesëmarrës	Pikë të grumbulluara në DN	% Saktësisë në DN
1	16 Shtatori	18	137	76
2	Baldushk	20	152	76
3	Vaqarr	21	158	75
4	Bërzhitë	23	174	75
5	Ahmetaq	26	197	75
..
..
57	Mjull Bathore	6	28	46
58	Ramazan Dervishi	10	45	45
59	Lalm	14	62	44
60	Shkallë	8	35	43
61	Bari Nela	8	28	35

RENDITJA E SHKOLLAVE NE TRE PROVIMET

Nr	Shkolla	Nr.nxënësve pjesëmarrës	Pikë të grumbulluara në Gjuhë shqipe	% Saktësisë në gjuhë shqipe	Pikë të grumbulluara në Matematikë	% Saktësisë në Matematikë	Pikë të grumbulluara në DN	% Saktësisë në DN	% SAKTESISE NE TRE LENDET
1	Sarina	28	484	86	517	92	212	75	87
2	Ahmetaq	26	376	72	417	80	197	75	76
3	Vahid Haka	14	221	78	209	74	103	73	76
4	Bërzhitë	23	375	81	324	70	174	75	76
5	14 Nëntori	12	178	74	187	77	88	73	76
..
..
57	Mjull Bathore	6	59	49	62	51	28	46	50
58	Lalm	14	155	55	118	42	62	44	48
59	Bari Nela	8	62	38	93	58	28	35	46
60	Shkallë	8	79	49	69	43	35	43	46
61	Kllojkë	5	45	45	40	40	25	50	44

KARTA E PERFORMANCËS

- Karta e Performancës, për vitin shkollor 2017-2018, konsistoi në 11 tregues qendrorë dhe në 1 tregues lokal (Pyetësorët).
- Rezultatet e treguesit lokal "Klima dhe etika" u përpunuan nga zhvillimi i pyetësorve (mësues-prind):
 - Në klasat VII të AMU-së dhe në klasat XI të AML-së.
 - Këtë vit shkollat u rankuan edhe për ndryshimin e renditjes KP 2017/ KP 2018.
 - Këto rezultate janë një tablo e qartë për cilësinë e shërbimit arsimor në 64 institucione arsimore të qarkut tonë.

REZULTATET E PROCESIT

- U bë rankimi i 18 shkollave të mesme dhe i 58 shkollave 9- vjeçare të qarkut tonë.
- Kundrejt këtij rankimi, secila shkollë shfrytëzon të dhënat e Kartës së Performancës për procesin e vetvlerësimit, duke ndërtuar një strategji të qartë të një planifikimi në nivel institucional (afatmesëm dhe atë vjetor).
- Drejtuesit e shkollave bëjnë një vlerësim real të punonjësve arsimorë, duke u bërë prezent arritjet dhe mosarritjet e tyre.
- Ne si DAR kemi evidentuar një panoramë reale për standardet dhe cilësinë e shërbimit arsimor të të gjitha niveleve, në institucionet arsimore të juridiksionit tonë .
- Në këtë këndvështrim, promovojmë dhe përhapim përvojat e suksesshme të atyre shkollave që kanë arritje të larta për tregues të vecantë, duke u ardhur në ndihmë shkollave të tjera me arritje jo të kënaqshme.
- Informojmë për arritjet e shkollave tona, të gjithë të interesuarit (komunitetin e prindërve, institucionet vendore), duke i bërë edhe ata aktorë dhe partnerë të rëndësishëm në këtë rrugëtim sa të vështirë po aq edhe fisnik.

RANKIMI RAJONAL KP 2018 PUBLIKE - GJIMNAZE

NR	EMRI I SHKOLLËS	RENDITJA PER TREGUES, KP 2018											RANKIMI RAJONAL KP 2018
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1	Sadik Stavileci	2	4	3	2	3	1	4	4	2	3	1	1
2	Sadi Nuri	6	3	2	3	2	2	1	8	11	5	2	2
3	Isa Boletini	4	3	3	4	1	3	1	10	3	6	10	3
4	I. Hasmema	10	6	7	3	3	2	1	1	5	7	6	4
5	Mersin Duqi	3	9	1	5	3	2	2	6	1	11	8	4
..
..
14	Myslim Shima	5	5	2	5	3	3	6	14	11	11	7	11
15	Feti Vogli	12	10	10	7	3	4	1	7	1	4	13	11
16	Kllojkë	14	14	8	13	3	3	1	3	8	12	1	12
17	Krrabë	9	10	9	8	3	3	3	15	6	7	11	13
18	16 Shtatori	15	13	7	12	3	2	1	9	13	12	15	14

RANKIMI RAJONAL KP 2018 JOPUBLIKE

NR	SHKOLLA	RANKIMI RAJONAL, KP 2018
1	NEW YORK	1
2	SARINA	2

RANKIMI RAJONAL KP 2018 PUBLIKE – 9-VJEÇARE

NR	SHKOLLAT	RENDITJA PËR TREGUES, KP 2018, 9 VJECARE												RANKIMI RAJONAL, KP 2018
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	LUNDËR	1	1	8	1	1	0	1	1	1	1	18	1	1
2	NDROQ-9VJ	1	2	7	4	1	0	1	2	11	1	16	1	2
3	MËZEZ-FUSHË	1	5	3	3	1	0	3	3	6	2	7	25	3
4	FARKË E MADHE	1	6	1 2	5	1	0	1	1	2	14	14	1	4
5	DOMJE	2	7	4	11	1	0	1	2	16	1	6	9	5
..
..
54	KASHAR-QENDËR	1	9	5	11	1	0	1	1	29	10	16	18	30
55	PEZË E MADHE	6	13	1	18	1	0	2	1	14	10	24	17	31
56	PICALLË	1	14	5	19	1	0	1	1	31	18	14	1	31
57	MJULL-BATHORE	1	7	4	3	1	0	1	4	23	1	23	42	32
58	KËRRABË	3	7	3	9	1	0	1	4	21	1	22	39	33

RANKIMI RAJONAL PER NDRYSHIMIN KP 2017 / KP 2018 - GJIMNAZE:


NR	EMRI I SHKOLLËS	RANKIMI KP 2017	RANKIMI KP 2018	RANKIMI PËR NDRYSHIMIN KP 2017/2018
1	100 vjetori i Pavarësisë	15	6	1
2	Ibrahim Hasmema	10	4	2
3	Mersin Duqi	10	4	2
4	Sadi Nuri	6	2	3
5	Bahri Nela	12	8	3
..
..
14	Kllojkë	10	12	8
15	Vajdin Lamaj	2	5	9
16	Feti Vogli	7	11	10
17	Farkë	3	8	11
18	Myslim Shima	5	11	12

RANKIMI RAJONAL PER NDRYSHIMIN KP 2017 / KP 2018 - 9 VJEÇARE:

NR	EMRI I SHKOLLËS	RANKIMI KP 2018	RANKIMI KP 2017	RANKIMI PËR NDRYSHIMIN KP 2017/2018
1	KLLOJKË	15	49	1
2	KUS	13	46	2
3	LAGJJA E RE	12	42	3
4	PEZË E VOGËL	6	28	4
5	MERSIN DUQI	13	34	5
..
..
54	PEZË E MADHE	32	22	30
55	MULLET	26	15	31
56	MJULL-BATHORE	33	19	32
57	BËRZHITË	18	1	33
58	BALDUSHK	30	10	34

REZULTATET E OLIMPIADAVE KOMBËTARE 2017-2018

SHKOLLA	LËNDA	VENDI I	VENDI II	VENDI III
ISA BOLETINI	Letërsi	1		
SADI NURI	Letërsi			1
NEW YORK HIGH SCHOOL	Gjeografi	1	2	1
NEW YORK HIGH SCHOOL	Histori	1		
NEW YORK HIGH SCHOOL	Biologji		2	1
NEW YORK HIGH SCHOOL	Kimi	2		1
NEW YORK HIGH SCHOOL	Fizike			1
TOTALI NË NIVEL DAR-I		5 (36%)	4(28%)	5(36%)



REZULTATE TË PROCESIT

Në nivel DAR-i përfaqësohemi me:

- 5 fitues të vendeve të para,
- 4 fitues të vendeve të dyta
- 5 fitues të vendeve të treta.

Përfaqësimet më dinjitoze për shkollat publike janë:

- Gjimnazi “Isa Boletini” Vorë me 1 fitues në vend të parë në lëndën e letërsisë.
- Gjimnazi “Sadi Nuri” me një fitues në vend të tretë, në lëndën e letërsisë
- Për shkollat jopublike është gjimnazi “New York” me 4 fitues të vendit të parë, 4 fitues të vendit të dytë dhe 4 fitues të vendit të tretë.

DETYRA PËR PËRMIRËSIM

- Të sigurojmë përmirësimin e burimeve njerëzore që do të japin mësim në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, duke përdorur politika sa më të përshtatshme për sigurimin e kuadrit të kualifikuar dhe efektiv.
- Të monitorojmë në vazhdimësi procesin e mësimdhënies në shkolla, duke mundësuar sa më shumë të jetë e mundur uljen e fiktivitetit, subjektivitetit dhe paaftësisë së vlerësimit korrekt.
- Të ndihmohen maturantët në këshillimin e karrierës, duke i orientuar ata sa më mirë drejt njohjes së aftësive të tyre dhe prirjeve apo drejtimeve që duhet të marrin pas përfundimit të shkollës.
- Të merren masa për një administrim korrekt dhe me njejtin standard të të gjithë provimeve të Maturës Shtetërore, në të gjitha qendrat dhe mjediset e zhvillimit të provimeve.

PRIORITETET KRYESORE PËR TË ARDHMEN

- Rritja e kapaciteteve njerëzore për zbatimin e kurrikulës së re.
- Investime në bazë materiale dhe didaktike, laboratore mësimore e kompjuterike, rritje e numrit të klasave digjitale.
- Rritja e cilësisë së arritjeve të nxënësve.
- Rritja e kapaciteteve për një arsim gjithëpërfshirës.
- Konsolidimi i shkollës si një institucion i hapur.

A. VEPRIMTARIA E SEKTORIT TË IT-ës DHE STATISTIKËS KA SYNUAR:

- Në realizimin e objektivave që lidhen me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në sistemin arsimor. Kjo veprimtari synon në zhvillimin përherë e në rritje të teknologjisë së informacionit në arsim, duke mundësuar rritjen e cilësisë të menaxhimit të informacionit arsimor. Prioritet kryesorë të veprimtarisë së këtij sektori janë: zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit në shërbimin arsimor, monitorimi, përmirësimi dhe shtimi i sasisë e cilësisë së sistemeve dhe pajisjeve elektronike në ndihmë të arsimit, siç janë: kompjutera, laptopë, printera, videoprojektorë, shërbim interneti i vazhdueshëm, si edhe përmbajtjeve multimediale në mësimdhënie.
- Në mirëmbajtjen e vazhdueshme të faqes elektronike të DAR-it, **dartiraneqark.edu.al**. në këtë faqe janë publikuar vazhdimisht materiale informuese, urdhra, udhëzime e njoftime të ndryshme në interes të nxënësve dhe shkollave të qarkut të Tiranës. Sektorëve përkatës në DAR, si edhe shkollave u është kërkuar vazhdimisht sjellja e informacioneve apo materiale mbi aktivitete të ndryshme për publikim, në hapësirën e faqes së web-it të DAR-it.

B. INFRASTRUKTURA E PAJISJEVE ELEKTRONIKE NË SHKOLLA

Nga database në “*google forms*”, që shkollat kanë plotësuar online, rezulton që kemi 48 kabinete informatike, 298 kompjutera, 30 laptopë, 52 projektorë dhe 62 printera funksional. Në gjimnazet « Isa Boletini » Vorë dhe « Myslim Shima » Yzberisht, ka në përdorim 132 copë tableta dhe 3 laboratorë të pajisur me projektorë interaktivë, ku zhvillohet “*mësimdhënia digjitale*”. Si DAR kemi 5 shkolla pa laboratorë informatike. Është kryer mirëmbajtje e pajisjeve elektronike në DAR, si edhe janë mbikëqyrur pajisjet TIK në shkolla. Gjatë vitit janë mbledhur informacione mbi gjendjen e pajisjeve TIK në shkolla, është vërejtur së një pjesë e mirë e kompjuterëve në shkolla kanë probleme, si dëmtime hardwerike apo softwerike dhe janë kryer riparimet e nevojshme, si instalim Sistemesh Operative, Office dhe programe të tjera të nevojshme për institucionet arsimore. Në disa shkolla kërkohen zgjidhje emergjente për zëvendësimin e pajisjeve TIK me të reja, pasi nuk kane asnjë pajisje laboratorike funksionale, për komunikim elektronik apo për zhvillimin e orëve mësimore në lëndën e informatikës.

Duhet theksuar që kompjuterat në laboratorët e informatikës, si rezultat i përdorimit për një kohë të gjatë, si dhe të mungesës së fondeve për mirëmbajtjen e tyre, vështirëson përdorimin efektiv në procesin mësimor dhe në administrimin e shkollës

C. SHËRBIMI I INTERNETIT NË SHKOLLA

- Pas realizimit të tenderit nga MASR-ja për shërbimin e internetit dhe lidhjen e kontratës nga DAR-i, për periudhën 09.10.2017 deri 31.12.2018, është siguruar shërbimi i internetit për 41 shkolla 9-vjeçare, 18 gjimnaze dhe zyrat e DAR-it, ndërsa 5 shkolla që kanë më pak se 81 nxënës nuk janë përfshirë nga MASR-ja për shërbim interneti.
- Sektori i IT-ës në bashkëpunim me shkollat, ka monitoruar zbatimin e kontratës, ku për rastet e mungesës së shërbimit janë marrë masat në përputhje me kontratën ndaj kompanisë Albtelecom. Bazuar në udhëzimet e MASR-së nuk kanë pasur internet shkollat për periudhën korrik – gusht, fakt që ka sjellë probleme, sidomos për gjimnazet, meqenëse ato e kanë pasur të domosdoshëm shërbimin e internetit për hedhjen e notave, mesatares dhe printimin e certifikatave të notave për maturantët.

D. ZHVILLIM PROFESIONAL, TË DHËNA STATISTIKORE

